



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Kuvendi – Skupština – Assembly

## **DITËT E KUVENDIT 2018**

Kuvendi i Republikës së Kosovës, me iniciativën e Forumit për Transparencë Parlamentare, organizon Ditët e Kuvendit 2018. Gjatë takimeve publike që do të zhvillohen në qytetet e Kosovës, qytetarët do të kenë mundësinë të diskutojnë drejtpërdrejt me deputetët.

Takimi i parë publik do të organizohet **në Gjilan, me datën 23 shkurt 2018**. Takimi mbahet në **Teatrin e Qytetit dhe fillon në orën 14:00**. Ftojme qytetarët e rajonit të Gjilanit të marrin pjesë.

### **SFONDI**

Kuvendi i Republikës së Kosovës, përmes Forumit për Transparencë Parlamentare, në kuadër të përpjekjeve për të shtuar komunikimin mes përfaqësuesve të zgjedhur dhe qytetarëve, gjatë vitit 2018 të organizoj Ditët e Kuvendit. Ky aktivitet parasheh që së paku një ditë në muaj, Kuvendi të organizoj takime publike me qytetarë, në një nga qytetet e Kosovës. Në këto takime marrin pjesë deputetët që vijnë nga zonat/rajonet e qytetit apo komunës ku edhe do të mbahen takimet.

Në këto takime qytetarët do të kenë mundësinë t'i takojnë deputetët dhe të diskutojnë për temat që për ta konsiderohen të rëndësishme. Diskutimi të orientohet drejt temave me interes nacional si zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendve të punës, luftimi i korrupsionit, liberalizimi i vizave, përmirësimi i sektorit të shëndetësisë dhe arsimit, si dhe çështje të tjera që konsiderohen të rëndësishme nga pjesëmarrësit.

Forumi për Transparencë Parlamentare vlerëson se duke mundësuar komunikim të drejtpërdrejt me qytetarët, organizimi i ditëve të Kuvendit do të ndikonte në rritjen e llogaridhënies së përfaqësuesve të zgjedhur ndaj zgjedhësve të tyre. Njëkohësisht, deputetëve do tu ofronte mundësinë të shpjegojnë dhe agumentojnë qëndrimet e tyre në raport me politikat publike, legjisllacionin dhe çështjet tjera të cilat trajtohen në Kuvend. Duke ndërtuar komunikimin e vazhdueshëm dhe të drejtpërdrejt me qytetarët, përfaqësuesit e zgjedhur i kontribojnë përpjekjeve për ta kthyer besimin e qytetarëve në institucionet demokratike.